




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



KA/Nr. 2913/20
Datë: 23/11/2020

Komisioni i Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i themeluar me Vendimin Nr.1448/20D, ta datës 04.09.2020, në përbërje të Faton Merovci, Muhamet Qerimi dhe Krenare Sogojeva Dermaku, në shqyrtimin e lëndës administrative, respektivisht ankesës së Kolegjit Fama, nr.ref.1257/20H të datës 19.08.2020 kundër Vendimit të KSHC Nr. 977/20D të datës 21.07.2020 për mos akreditim Institucional, e pranuar më 23.10.2020, në mbështetje të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e datës 11.11.2020, me shumicë votash, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Kolegjit Fama nr. Ref.1257/20H e datës 19.08.2020 dhe vërtetohet Vendimi i KSHC-së Nr. 977/20D i datës 21.07.2020.

ARSYETIM

Kolegji Fama më datë 19.08.2020, brenda afatit ligjor ka parashtruar Ankesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, përmes së cilës ka kërkuar që Komisioni i Ankesave të rishqyrtoj vendimin e KSHC-së të datës 21.07.2020, nr. 977/20D, me të cilin nuk është riakredituar në nivel Institucional. Pala me Ankesën e datës 19.08.2020 pretendon se:

Këshilli Shtetëror i Cilësisë pa të drejtë ka refuzuar akreditimin në nivel Institucional duke bërë shkelje e nenit 18.4, lidhur me nenin 4.2, nënparagrafi 2.2 i UA MASHT 15/2018, pasi që në vendimin e KSHC-së Nr. 977/20D të datës 21.07.2020 nuk është sqaruar kuorumi, përbërja dhe votimi me rastin e marrjes së vendimit. Pala po ashtu pretendon se është bërë shkelje e nenit 16, lidhur me nenin 15.1, nënparagrafi 1.2-1.3 të UA MASHT 15/2018 sepse takimi online i organizuar me rastin vlerësimit të Kolegjit Fama nuk ka asnjë bazë ligjore.

Pala po ashtu pretendon se detyra e grupit të ekspertëve, gjatë procedurës vlerësues ne vitin 2020 ishte vetëm vlerësimin i përmbushjes/plotësimit të rekomandimeve të dhëna ne vitin 2019, sepse procesi aktual i akreditimit është vazhdimësi e procesit të akreditimit të vitit 2019.

Provat e administruara:

- Ankesa nr.ref.1257/20H të datës 19.08.2020;
- Vendimi i KSHC-së Nr. 977/20D, datë 21.07.2020;
- Procesverbali i datës 25.06.2020;
- Raporti final i ekipit të ekspertëve;
- Raporti i KSHC-së për rishqyrtimin e ankesës nga takimi i datës 02.09.2020

Shpjegim i situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi

Komisioni i Ankesave pranë AKA-së, ka pranuar ankesën nr. 1257/20H, datë 19.08.2020, e Kolegjit Fama më datë 23.10.2020, së bashku me dokumentacionin dhe raportin e KSHC-së nga takimi i datës 02.09.2020, me të cilën ka përshkruar pretendimin e palës dhe arsyen e refuzimit të kërkesës për akreditim.

Komisioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkëngjitura ka gjetur se:

Pretendimi i palës se me rastin e marrjes së Vendimit në fjalë KShC nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm nuk qëndron, pasi një gjë e tillë është dëshmuar me procesverbalin e takimit të datës 25.06.2020 në të cilin kanë marrë pjesë:

1. Gazmend Luboteni, Kryetar i KSHC-së
2. Vjollca Krasniqi, Zëvendës-Kryetare e KSHC-së
3. Rozafa Kuliqi, anëtare
4. Arta Jakupi, anëtare
5. Dukagjin Zeka, anëtar
6. Herb Amato, anëtar
7. Jeffry Butel, anëtar
8. Magdalena Ziolo, anëtar
9. Naim Gashi, ex officio anëtar

Nga procesverbali i datës 25.06.2020 i siguruar nga AKA shihet se për Kolegjin Fama, me 8 vota për, 0 abstenime dhe 0 vota kundër është votuar raporti i eksperteve për mos-akreditimin në nivel institucional.

Ndërsa për pretendimin e palës se nuk ka pasur bazë ligjore për të organizuar vlerësimin online nga AKA, Komisioni i Ankesave ka gjetur se ky organizimin për vlerësimin online është i mbështetur me vendimin e Ministrisë së Arsimit nr. 1086 të datës 07.05.2020 për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID19.

KSHC për vendimin e marrë për mos akreditim institucional të Kolegjit Fama është bazuar në Raportin e ekipit të ekspertëve ndërkombëtar. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë i angazhuar nga AKA për vlerësimin e Kolegjit Fama ka konstatuar se nga gjithsej 11 kapituj të standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit (korrik 2018), Kolegji Fama përmbushë substancialisht 2 standarde, pjesërisht 6 dhe nuk përmbushë 3 standarde. Po ashtu, ekipi i ekspertëve në fund të raportit ka rekomanduar që të mos akreditohej në nivel Institucional Kolegji Fama.

Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave

Komisioni i Ankesave, pasi ka konstatuar se ankesa e Fama është parashtruar brenda afatit kohor, ka shqyrtuar pretendimet e palës për mos akreditimin institucional.

Komisioni i Ankesave e ka analizuar raportin e ekspertëve ku ekspertet ndërkombëtar nuk kanë rekomanduar akreditimin në nivel institucional të Kolegjit Fama sepse i njëjti nga gjithsej 11 kapituj të standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, Kolegji Fama përmbushë substancialisht 2 standarde, pjesërisht 6 dhe nuk përmbushë 3 standarde.

Baza ligjore e vendimit dhe arsyeja pse është e zbatueshme në rastin konkret

Bazuar në nenin 18, paragrafi 2 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, i cili përcakton se: *"Duke u bazuar në rekomandimet nga raporti i vlerësuesve të jashtëm, KSHC merr vendimin për akreditim ose mos akreditim."*

Nga kjo, mund të vërehet se nuk janë përmbushur kërkesat ligjore për përmbushjen e standardeve sipas Manualit të Akreditimit (Korrik 2018), i cili përcakton se: *"Për të marrë një vendim pozitiv për programin dhe ri-akreditimin institucional, çdo ofrues i arsimit duhet të demonstrojë të paktën një nivel të konsiderueshëm pajtueshmërie në gjykimin e përgjithshëm. Prandaj, dështimi në përmbushjen e të paktën një niveli të përgjithshëm të pajtueshmërisë përfshinë vonimin, tërheqjen, pezullimin ose mohimin e akreditimit"*

Andaj, sipas nenit 18, paragrafin 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, Komisioni i Ankesave vlerëson se deri sa KSHC merr vendim bazuar në rekomandimet nga raporti i ekspertëve të jashtëm, atëherë Vendimi nr. 982/20D, datë 21.07.2020 i KSHC-së ka bazë ligjore dhe arsyeshmëri të plotë.

Pala me datë 29.10.2020, ka qenë e ftuar nga Komisioni i Ankesave për ta ushtruar të drejtën e vet për tu dëgjuar, ashtu siç e parashihet në nenin 95 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kolegji Fama e ka realizuar këtë të drejtë, por nuk ka parashtruar prova dhe argumente shtesë.


Në përfundim,

Komisioni i Ankesave pasi shqyrtimit dhe administrimit të provave, vërtetimit të gjendjes faktike dhe legjislacionit në fuqi, mbi bazën e kompetencave të dhëna me nenin 22, paragrafin 3 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Komisioni i Ankesave në AKA


KA/Nr. 2918/20, datë 23/11/2020

Procesmbajtësi



Arianit Krasniqi

Kryetari i Komisionit të Ankesave



Faton Merovci



Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve në gjykatën kompetente për konfliktet administrative.